



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:208170

Datë: 18.04.2023

Numri i dokumentit: 04195704

PS.nr.29/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL, në përbërje të Trupit Gjykses, gjyqtarëve Arben Hoti- Kryetar, Mentor Bajraktari dhe Valbona Musliu Selimaj - Anëtar Të Trupit Gjykses dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit R R për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273/2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.68/2013 të dt.02.12.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 13.03.2023 në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës – Naim Abazi, i pandehuri R R, mbrojtësi i të pandehurit av.Rexhep Kaçaniku sipas detyrës zyrtare dhe dëshmitarit Agim Koca, pas seancës për këshillim dhe votim me datë 15.03.2023, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurit:

R R, me nofkën "...", nga babai ... dhe e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me dt...., i martuar, baba i katër fëmijëve, din shkrim dhe lexim, me vendbanim në fshatin ... KK Skenderaj, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i gjykuar për grabitje, me numër

personal ...të lëshuar nga MPB – RKS, pronar i Rent a Car “...” sh.p.k me seli në ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPPRK-së, i pandehuri:

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Pa autorizim kanë shpërndarë, transportuar, dorëzuar, ndërmjetësuar dhe kanë shitur substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotik duke vepruar si anëtar të grupit, kështu që i pandehuri E Ç pa autorizim ka blerë substanca narkotike të llojit mariuhane pastaj ka ndërmjetësuar dhe ua ka shitur personave të ndryshëm, ashtu që në muajin nëntor të vitit 2012 dhe në muajin shkurt të vitit 2013 në Mitrovicë prej të pandehurit Xh I ka blerë 100 gram substanca narkotike të llojit mariuhane për çmim prej 80,00 euro, si dhe 100 gram tjera për çmim prej 100,00 euro, ndërsa gjatë kontrollit të shtëpisë së të pandehurit E me datë 08.02.2013 policia ka gjetur dhe konfiskuar 40 paketime me substanca narkotike te llojit kanabis (mariuhane) me peshë prej 66,69 gram, i pandehuri Xh I pa autorizim është furnizuar me substanca të llojit mariuhane pastaj ka ndërmjetësuar dhe ua ka shitur personave të ndryshëm si dhe te pandehurit E në mënyrë të përshkruar si më lartë, kurse i pandehuri A M pa autorizim është furnizuar me substanca narkotike nga i pandehuri S I dhe E Ç, pastaj ua ka shitur personave të ndryshëm dhe ka ndërmjetësuar me qëllim të shpërndarjes dhe të shitjes së substancave narkotike të llojit mariuhane me peshe prej 20,33 gram, dhe të njëjtën dite ne banesën e te pandehurit S në Mitrovicë policia ka gjetur dhe ka konfiskuar 9,72 gram substanca narkotike te llojit kanabis (mariuhane), kurse i pandehuri A G i cili gjendet në arrati pa autorizim pa autorizim është furnizuar me substanca të llojit mariuhane nga i pandehuri A M dhe ka ndërmjetësuar dhe iu ka shitur personave të ndryshëm, po ashtu edhe te pandehurit Q A i cili gjendet në arrati dhe i pandehuri R R janë furnizuar pa autorizim me substanca narkotike te llojit mariuhane pastaj ua kanë shitur personave të ndryshëm në atë mënyrë që këto substanca i kanë blerë në Shqipëri e pastaj nga Kosova për ti shitur dhe për të ndërmjetësuar i kanë transportuar për në Austri, ndërsa me datë 07.06.2013 policia gjatë kontrollit të shtëpisë së të pandehurit Q ka gjetur dhe konfiskuar 1,91 gram substanca narkotike te llojit kanabis (mariuhane).

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31, e dënueshme sipas nenit 281 par.1 nënpar.1.1. të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien ne barre te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

1.1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë me numër PPS.nr.68/2013 me datë 02.12.2013 kundër të pandehurve E Ç, Xh I, A M, S I, dhe R R për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31, e dënueshme sipas nenit 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

1.2. Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 06.07.2021 ka marr aktgjykim PS.nr.11/19 ndaj të pandehurve Xh I, A M dhe S I të cilët i ka shpallur fajtor dhe i ka dënuar me dënim burgimi dhe dënim me gjobë si dhe dënimin plotësues.

1.3. Sa i përket të pandehurit E Ç e njëjta gjykatë me datë 24.12.2019 ka marr aktvendim me të cilin ka pushuar procedurën penale ndaj të njëjtit për shkak të vdekjes.

1.4. Gjithashtu e njëjta gjykatë me datë 17.06.2021 ka marr aktvendim për veçimin e procedurës ndaj të pandehurit R R për shkak të ekonomizimit të procedurës penale, pasi kjo gjykatë ka pranuar Memorandumin zyrtar nga policia e Kosovës në të cilin është konstatuar se i njëjti gjendet në Austri në adresë të panjohur, ndërsa ndaj të pandehurit R R ka lëshuar urdhër arrest dhe aktvendim për caktimin e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj nga momenti i arrestimit të tij.

1.5. Gjykata me datë 04.11.2021 ka mbajtur seancën e dëgjimit pas arrestimit të pandehurit R Ri cili është ndaluar me datë 03.11.2021. Gjykata me datë 04.11.2021 këtij të pandehuri i ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj dhe atë deri me datë 03.12.2021.

1.6. Gjykata në këtë çështje penalo juridike ndaj të pandehurit R R ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore dhe me datë 22.11.2021 ka marr aktgjykim PS.nr.28/21 ku të pandehurin

R Re ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me dënim burgimi prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro.

1.7. Gjykata e Apelit të Kosovës me datë 04.04.2022 ka marr aktgjykim APS.nr.4/2022 ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PS.nr.28/2021 të dt.22.11.2021 vetëm në aspektin e kualifikimit juridik të veprës penale ku kjo gjykatë ka gjetur se me veprimet e të pandehurit përbehen gjitha elementet e veprës penale Blera, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273/1 të KPRK-së, ndërsa pjesën tjetër të aktgjyimit nuk e ka ndryshuar.

1.8. Gjykata Supreme e Kosovës me datë 07.07.2022 ka marr aktgjykim Pml.nr.255/2022, me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarit R R duke anuluar aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, dhe lëndën e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje për të eliminuar paqartësisë dhe pas administrimit të serishëm të provave duke udhëzuar gjykatën e shkallës së parë të jap arsyet ligjore për faktet vendimtare që janë elemente qenësorë të veprës penale për të cilën i pandehuri është ngarkuar. Gjykata Supreme e Kosovës ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që vërtetoj faktet vendimtare në lidhje me figurën e veprës penale më të cilën është akuzuar R R, e që konsistojë në atë që të vërtetohet fakti nëse i pandehuri e ka blerë apo poseduar narkotik dhe a e ka bërë me qëllim të shitjes apo shpërndarjes. Tutje Gjykata Supreme e Kosovës në vendimin e përmendur ka theksuar se pasi gjykata e shkallës së dytë i ka kushtuar rëndësi bisedave telefonike, ka pasur nevojë që të vërtetoj se çka është vërtetuar nga ato, sepse kjo ka qenë edhe pretendim ankimorë i mbrojtjes, nëse dihet se tek i dënuari nuk është gjetur narkotik dhe asnjëri i dëgjuar nuk ka deklaruar për veprime inkriminuese të R R. Në fund të aktvendimit është udhëzuar gjykata e shkallës së parë që varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të merr vendim të ligjshëm.

2. Shqyrtimi gjyqësor në rigjykim dhe deklaratimet e palëve

2.1. Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të lëndës, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore me datë 20.02.2023 dhe 13.03.2023 në të cilën ish-in të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale – Naim Abazi, i pandehuri R R me mbrojtësin av.Rexhep Kaçaniku sipas detyrës zyrtare si dhe dëshmitari A K.

2.2. Të pandehurit R R i është lexuar aktakuza, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi u bind se i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e akuzës, të njëjtit i dha mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri R R është deklaruar i pafajshëm sa i përket veprës penale me të cilën e ngarkon akuza.

2.3. Pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve ku prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve.

2.4. Dëshmitari Agim Koca në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023 ka deklaruar se të pandehurin R R nuk e njeh personalisht, nuk ka kurrfarë lidhje me të, se nuk ka pas bisede e as kontakt me të njëjtin por e ka njohur si emër të cilin ja ka përmendur A M, por nuk i kujtohet për çka ja ka përmendur sepse ka kaluar kohë e gjatë. Dëshmitari në këtë shqyrtim ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratave që i ka dhënë në polici dhe në gjykatë.

3. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

- Shënimi zyrtar nga policët hetues në DHTN Mitrovicë të datës 08.02.2013.
- Raporti informues i Policisë së Kosovës i datës 10.04.2013 të cilët janë bashkangjitur transkriptet nga përgjimi ligjor mes të pandehurit R R dhe persona të ndryshëm.
- Raporti i policisë - hetuesisë së Kosovës lidhur me bisedat telefonike që ka pas i pandehuri R R me të pandehurin Q A,
- Ekspertiza e ekspertit të Forenzilës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë të ekspertit S M.

4. Mbrojtja e të pandehurit

4.1. I pandehuri R R në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 13.03.2023, mes tjerash ka deklaruar: se në shtëpinë e tij nuk është gjetur sasi e marihuanes e asnjë send tjetër. Sa i përket të pandehurve e njeh vetëm Q A dhe Xh I si qytetar të Mitrovicës ndërsa të tjerët jo. Se në Shqipëri nuk ka blerë mariuhanë atje ka shkuar disa here sepse ka pasur të sëmurë babin e tij, të shtrirë në spital. Më pas ka shtuar se nuk ka transportuar marihuaë apo ndonjë narkotik tjetër.

Sa i përket të pandehurit Q A ka deklaruar se të njëjtin e ka kushëri, vëllain e tij të ndjerë e ka pas në gjeneratë dhe se Q e ka marrë për të punuar në kafën e tij. Sa i përket personit me emrin M T nga Suhareka ka deklaruar se e njuh vetëm përmes rrjeteve sociale. Nga muaji Tetor 2012 e deri në muajin Shkurt 2013 ka deklaruar se nuk ka pas punë me mariuhane e as nuk ka poseduar. Se personin me emrin Xh M e ka njohur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë në vitin 2004-2005 sepse në atë kohë i pandehuri ka qenë në burg për vjedhje, duke shtuar se pas burgut është takuar me Xh ka qenë në shtëpinë e tij ka ndejur gjithashtu edhe Xh ka qenë në shtëpinë e tij me grua dhe fëmijë për vizitë, por se tani nuk e dine se i njëjti ku ndodhet.

4.2. I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se tërë kohën ka jetuar jashtë vendit si në Austri, Francë e Slloveni e që tani vepron me biznes në Poloni e që në vitin 2013 nuk ka qenë jashtë vendit. Në pyetjen e prokurorit, citat *“një telefonat që e ke pas me Xh që ke porositur diçka ai ty te ka porositur, në lidhje me çka ka pas kjo bisedë të bëjë”*, i pandehuri është përgjigjur, citat *“do te përgjigjem ndoshta krejt nuk me kujtohet por diçka dhe këtë telefonat nuk e harroj deri të vdes. Atëherë kam qenë në gjendje të tillë ekonomikisht (te vështirë) edhe po e kam pas një telefonat me Xh M kujtoj ka qenë në lidhje me M T, tash nuk më kujtohet saktësisht por e kemi mashtruar dhe ja kemi marr 200 apo 250 euro nuk jam i sigurt, kjo ka qenë ajo telefonata që e kam pas me Xh M”*. Se kjo telefonat ka pas të bëjë në lidhje me 5 gram droge – pra me heroine ku i pandehuri i kishte thënë merre do kakao apo biber pështjellja e merrja parat (i pandehuri për këtë pikë ka deklaruar se tani sot i vjen keq për atë çka ka ndodhur). I pandehuri më tej ka theksuar se ato para i ka pranuar nga Xh M ku ky i fundit personin e trete pra M T i ka dhënë kakao të cilën e ka përgatitur Xh dhe sipas të pandehurit vërtetohet edhe përmes telefonatave, sepse ky personi tretë ka pas ankesa duke thënë se i ka dhënë berllog,

4.3. I pandehuri ka deklaruar se në Kukës ka qenë njëqind herë sipas tij dhe se atje ka shkuar te Sh F i cili tani jeton në Durrës, por më shpesh ka shkuar edhe në Tiranë sepse ka pasur të sëmur babin e tij, gjithashtu ka pasur edhe shokë nga Tiranës por se te të njëjtit nuk ka shkuar në shtëpitë e tyre.

5. Fjala përfundimtare e palëve

5.1. Prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Naim Abazi në fjalën përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të datës 13.03.2023 ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me datë 19.11.2021, duke shtuar se në këtë çështje penale në bazë

të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë si dhe në bazë të asaj gjendje faktike në mënyrë të qartë është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit R R manifestohen të gjitha elementet e veprës penale duke bashkëpunuar edhe me të akuzuar të tjerë gjithnjë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore apo çfarëdo dobie tjetër për veti apo për tjetrin, kjo vërtetohet edhe në bazë të provave të administruara. Duke konsideruar se të gjitha provat e administruara në këtë çështje do të vërtetojnë faktin e pa kontestuar se i pandehuri R R ka kryer veprën penale të cekur si në dispozitivin e aktakuzës PPS.nr.68/2013 të dt.02.12.2013. Në fund të paraqitjes së fjalës së tij prokurori ka shtuar se gjykata me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh edhe rregullat e përgjithshme lidhur me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale, pasi që të akuzuarit pa autorizim kanë shpërndarë, transportuar, dorëzuar, ndërmjetësuar dhe kane shitur substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, si dhe pas analizimit të këtyre rrethanave veç e veç të pandehurin R R gjykata ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

5.2. Mbrojtësi i të pandehurit av.Rexhep Kaçaniku në fjalën përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të datës 13.03.2023 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me datë 19.11.2021, në të cilën mes tjerash ka theksuar: se asnjëri nga të pandehurit nuk kanë deklaruar se i mbrojturi i tij ka blere substance narkotike të llojit mariuhanë, edhe dëshmitari i vetëm A K ka deklaruar se fare nuk e njeh të mbrojturin e tij e në këtë rast përjashtohet mundësia që nga ai të ketë blere substance narkotike, gjithashtu as në aktakuzë nuk është përmendur asnjë person që ja shiti substancën narkotike të mbrojturit të tij. Me rastin e bastisjes së shtëpisë të R R nuk është gjetur në posedim substanca narkotike e llojit mariuhanë. Mbrojtësi më tej ka theksuar se i mbrojturi i tij fare nuk kishte në posedim substance narkotike dhe është iluzore të flitet për shpërndarjen e sendit që nuk e ke në mbizotërim gjë të cilën nuk e ka dëshmuar as prokuroria dhe asnjë person nuk mund ta shesë sendin që nuk e ka. Prokuroria nuk ka përshkruar veprimet konkrete të pandehurit lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet ka shtruar mbrojtësi. Se prokuroria gjykatës i ka ofruar raportin informues të policit të dt.10.04.2013 pa i cituar shënimet themelore të tyre, raportin informues të policit hetues të dt.14.05.2013 lidhur me bisedat telefonike të pandehurve Q A dhe R R e asgjë tjetër kur është në pyetje përgjegjësia penale e të mbrojturit të tij. Mbrojtësi më tej ka cekur se vështrimi i foto dokumentacionit që gjendet në shkresa të lëndës nuk e inkriminojnë të mbrojturin e tij se ka ndërmarr veprime të cilësuar si vepër penale por përkundrazi flasin për mungesën e provave relevante se është i përfshirë në këtë veprimtari kundërligjore. Mbrojtësi ka konsideruar se në mungesë të provave

relevante se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet duhet të aplikohet parimi “in dubio pro reo”. Mbrojtësi krejt në fund ka propozuar se që i mbrojturi i tij R R të lirohet nga përgjegjësia penale nga aktakuza sepse nuk është dëshmuar se ka kryer vepër penale në mungesë të provave.

6. Gjetjet e Gjykatës.

6.1. Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të tyre, secilës veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, ka arritur tek përfundimit se nuk ka prova të mjaftueshme, me të cilat vërtetohet se i pandehuri R R ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë.

6.4. Nga provat personale të propozuar për administrim në shqyrtimin gjyqësor pra dëshmia e dëshmitarit A K nuk është dëshmuar se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ngase dëshmia e tij nuk përmban asgjë inkriminuese në raport me të pandehurin R R, ai thjeshtë ka deklaruar se nuk e njeht atë dhe se nuk ka pasur asnjë raport.

6.5. Nga prova materiale e administruar në shqyrtimin gjyqësor Raporti informues i Policisë së Kosovës i datës 10.04.2013 të cilët janë bashkangjitur transkriptet nga përgjimi ligjor mes të pandehurit R R dhe persona të ndryshëm, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj tezën e aktakuzës së prokurorisë përtej dyshimit të bazuar mirë.

Nga këto përgjime të telekomunikimeve gjegjësisht telefonatave vërehet se i pandehuri R R ka disa kontakte me persona NN nga Republika e Shqipërisë, po ashtu i njëjti komunikon edhe me personin Q A e që sipas aktakuzës të njëjtit e kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje. Teoria e akuzës bazuar në këto telefonata e ka lidhur të pandehurin R se ka blerë me qëllim shitje substancat narkotike të ndaluara nga persona të panjohur nga Republika e Shqipërisë. Gjykata vlerëson se nga përgjimet e tilla, nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar se këto telefonata janë bërë me qëllim blerjen e narkotikut, për faktin se ato nuk mbështeten në ndonjë provë tjetër materiale dhe as personale, si psh; vërtetim për konfiskimin e lëndës narkotike, apo dëshminë e ndonjë dëshmitari. Pra, tek i pandehuri R R nuk është gjetur ndonjë lloj narkotiku i ndaluar me ligj, që të mund të vërtetohen dyshimet të cilat krijohen nga përgjimet. Këto përgjime do të mund të ishin një bazë e mirë për të filluar një hetim dhe më pastaj ne punë operative të punohej në zbulimin dhe ndriçimin e plotë të këtyre dyshimeve se i pandehuri ka kryer vepër penale duke blerë substanca narkotike të ndaluara me ligj me qëllim shitje. Pra për rrjedhojë, nga këto përgjime të telekomunikimeve nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti

nga persona nga Republika e Shqipërisë ka blerë narkotik me qëllim shitje dhe si të tilla këto përgjime nuk mund të interpretohen në mënyrë arbitrare dhe të krijohet narracioni se pikërisht të njëjtat vërtetojnë kryerjen e veprës penale, kjo për faktin se këto biseda janë biseda të cilat nuk janë qartësisht inkriminuese sepse janë të përgjithësuara dhe nuk mund të nxirren nga konteksti (edhe pse në disa raste mund të konkludohet se pjesëmarrësit në bisede po bënin biseda të koduara), por edhe për faktin se këto biseda nuk kanë mbështetje në asnjë provë tjetër, andaj lidhur me këtë rrethanë kryesore për ekzistimin e veprës penale të njëjtat duhet të interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij bazuar ne parimin in dubio pro reo.

6.6. Po ashtu edhe nga bisedat e të pandehurit R R me të pandehurin Q A , prokuroria pretendon se të njëjtat kanë bashkëpunuar në kryerjen e veprës penale. Edhe sa i përket kësaj rrethane gjykata e shkallës së parë konstaton se fillimisht nuk është vërtetuar blerja apo posedimi i narkotikut me asnjë provë, pra blerja apo posedimi ka mbetur në nivelin e hipotezës, po ashtu njëjtë nuk është vërtetuar shitja, këto biseda të cilat janë abstrakte pra jo konkrete janë një bazë për fillimin e hetimit, mirëpo sa i përket të pandehurit R R më pastaj organet e ndjekjes nuk kanë gjetur prova tjera inkriminuese, ngase në bazë të provave që ka prezantuar prokuroria, gjykata ka gjetur se të njëjtat nuk provojnë asgjë përtej dyshimit të bazuar mirë, sepse nuk mbështeten në asnjë provë tjetër të vetme, thjeshtë është një dyshim se po flitet për veprimtari kriminale, e cila ka mbetur e pa provuar.

6.7. Në lidhje me pjesën e dispozitivit të aktakuzës në të cilin thuhet se i pandehuri R R dhe Q A pasi që substancat i kanë blerë në Shqipëri (rrethanë kjo e cila nuk është vërtetuar), këto substanca i kanë shitur në Austri dhe këtë fakt prokuroria pretendon se e ka provuar në baza të masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, gjegjësisht përgjimit të telekomunikimeve, e që sipas gjykatës dëshmi për një transport të tillë nuk ka, por se prokuroria është nisur nga këto përgjime në fakt nga Memorandumi Zyrtarë i Policisë i datës 10.04.2013 në të cilin janë transkriptuar përgjimet dhe në hyrje të këtij dokumenti thuhet se i pandehuri R R komunikon me një person me numër ... e për të cilin person policia dyshon se jeton në Austri. Pra sipas gjykatës edhe kjo pjesë ka mbetur e pa provuar, fillimisht për faktin se edhe në këtë rast bisedat mund të jenë vetëm një indicije për fillim hetimi ngase në vetvete në këtë rast nuk provojnë veprën penale, pra janë biseda në bazë të cilave mund të supozohet se behet fjalë për aktivitet kriminal por që ky është vetëm supozim dhe në rrugë tjera operative për të pandehurin R nuk është provuar asgjë dhe krejt teorinë e akuzës se narkotikët për të cilët nuk dihet as sasia as koha e as kur janë blerë apo kur kanë qenë në posedim të pandehurit qenkan transportuar për në shtetin e Austrisë dhe

kjo qenka vërtetuar se dyshohet se ky person jeton në Austri dhe këtë e ka thënë policia të cilët këtë fakt e kanë supozuar dhe jo provuar me prova konkrete. Gjykata në këtë logjikë konsideron se edhe pjesa kur i pandehuri deklarohet së bashku me Xh M kishin përgatitur një plan që të shisnin M T kinse për pesë gram heroin t'ia kamuflonin me kako apo biber siç shprehet i pandehuri R dhe këtë plan e kishte realizuar Xh, pra sipas udhëzimeve të pandehurit, edhe në këtë pikë megjithëse ngjanë shumë e dyshimit, prokuroria nuk ka arritur me ndonjë provë tjetër këtë rrethanë, pra provë konkrete qoftë konfiskim qoftë ndonjë provë që e lidhë direkt të pandehurin në kryerjen e veprës penale, andaj edhe në lidhje me këtë rrethanë gjykata bazuar në parimin “in dubio pro reo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen pra në lidhje me këtë rrethanë e interpretohen në favor të pandehurit dhe drejtave të tij, pra mbrojtja e të pandehurit lidhur me këtë rrethanë mbetet e pa rrëzuar si tezë nga prokuroria sepse nuk ka një provë të drejtpërdrejtë që do ta dëshmonte të kundërtën.

6.8. I pandehuri R R është akuzuar për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata arsyetimin e këtij aktgjykimi do të filloj nga forma e kryerjes së veprës penale që i është vënë në barrë të pandehurit, e cila dispozitë përcakton:

Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Për të ekzistuar kjo vepër penale janë paraparë katër forma të veprimit dhe secili veprim paraqet formë të posaçme me të cilën kryhet kjo vepër penale. Në rastin konkret ashtu siç u potencua më lartë nuk është vërtetuar blerja apo posedimi i narkotikut nga ana e të pandehurit R me qëllim shitje, e as ndonjëra nga këto katër format e kryerjes së veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2, pra shpërndarja, shitja, transportimi, ndërmjetësimi, apo dërgimi me qëllim shitje, pra asnjë nga këto veprime nuk janë vërtetuar në bazë të provave, e të cilat veprime do të përbënin element të veprës penale.

Gjithashtu për këtë të pandehur nuk janë vërtetuar të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku rëndësi të veçantë ka edhe sasia e narkotikut e cila sipas prokurorisë është shitur, pra nuk ka ndonjë provë cila ka qenë sasia eventuale, përveç që në dispozitivin e aktakuzës është përcaktuar se të

bashkëryesi Q A, gjegjësisht gjatë kontrollit të shtëpisë së tij janë gjetur 1,91 gram substancë narkotike të llojit marihuanë.

6.9. Gjykata do t'i bëjë një analizë edhe formës së kryerjes së veprës penale, apo bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të paraparë në nenin 31 të KPRK-së, si Bashkëkryerja, që përcakton: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”*.

Pra, për t'u konsideruar bashkëkryerja, midis të pandehurve duhet të shprehet lidhja e caktuar subjektive dhe objektive.

Lidhja objektive qëndron në atë që secili bashkë kryes duhet të marrë ndonjë veprim me të cilin i kontribuon kryerjes së veprës penale, pa marrë parasysh se këto veprime a merren në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, por duhet të jenë të lidhura midis tyre, dhe të jenë të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë.

Lidhja subjektive qëndron në atë se të gjithë bashke kryesit duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

Për ekzistimin e bashkëkryerjes i pandehuri duhet të marrë pjesë në kryerjen e veprës penale dhe thelbësisht ose në ndonjë mënyrë tjetër t'i kontribuoj kryerjes së veprës penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjatë administrimit të provave dhe dëshmisë së dëshmitarit si dhe nga mbrojtja e te pandehurit nuk është provuar se i pandehuri është pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale sepse i pandehuri nuk i ka njohur asnjë nga të pandehurit e tjerë në këtë çështje penalo juridike e as dëshmitarin e vetëm të propozuar nga prokuroria, e as nuk përshkruhet ndonjë veprim konkret si për shembull koha apo vendi i saktë i kryerjes së veprës penale, nuk përshkruhet fare itinerari i lëvizjeve apo veprimeve të pandehurit R R.

Edhe në këtë rast sikurse edhe në rastet tjera gjykata detyrohet që bazuar në nenin 3 të KPPK-së, i cili nen përcakton parimin “in dubio pro reo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit interpretohen në favor të pandehurit dhe drejtave të tij.

Përfundimisht në veprimet e të pandehurit R R nuk formësohen elementet e formës së kryerjes së veprës penale e që më këtë rast është Blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

7.1. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 453 par.1. të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr. 29/22, dt.12.04.2023

Sekretare juridike:
Shqipe Rexhepi

Kryetari i Trupit Gjykes - gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.